

V E N D I M
Nr.238, datë 6.6.1994

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.529, DATË
11.12.1992 “PËR KRITERET DHE KOMPETENCAT E ORGANEVE SHTETËRORE DHE
PRIVATE NË FUSHËN E STANDARDIZIMIT DHE CILËSISË”**

Me propozimin e Drejtorisë së Standardizimit dhe të Cilësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.529, datë 11.12.1992, neni 5, paragrafi i fundit ndryshohet si më poshtë:

“Në etiketat e prodhimeve farmaceutike, imunobiologjike, veterinare, higjieno-shëndetësore dhe të prodhimeve kimike vendoset edhe afati maksimal i përdorimit. Etiketimi i prodhimeve ushqimore do të bëhet sipas standardit të FAO/OMS-it, CODEX STAN 1-1985 “Norma të përgjithshme për etiketimin e mallrave ushqimorë të ambalazuara”.

Në rastet kur këto prodhime shiten në mënyrë të fraksionuar, afati maksimal i përdorimit shënohet në fraksionin më të vogël”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi